



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr.848/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada – Gllogjan anëtar, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Anita Peci, duke vendosur përkritazi me apelin e parashtruar nga Bukuriye Makolli kandidate për anëtare për Kuvendin Komunal në Prishtinë nga subjekti politik Aleanca Kosova e Re (AKR), dega në Prishtinë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017, për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunalë, të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si i pabazuar apeli i parashtruar nga Bukuriye Makolli kandidate për anëtare për Kuvendin Komunal në Prishtinë nga subjekti politik Aleanca Kosova e Re (AKR), dega në Prishtinë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017, për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunalë, të mbajtura më datë 22.10.2017.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datën 10.11.2017 në ora 09:55, ka pranuar një apel nga Bukuriye Makolli kandidate për anëtare për Kuvendin Komunal në Prishtinë nga subjekti politik Aleanca Kosova e Re (AKR), dega në Prishtinë, me të cilin pretendon se dyshon se në vendvotimet 1927e/03/04/05/06/07, 1920e, 1918e, 1937e, ka pasur manipulime pasi që numri i votave të saj nuk rezulton me numrin e votave të familjarëve të cilët e kanë votuar atë.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të besueshmërisë së apelit dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

Paneli pas vlerësimit të pretendimeve ankimore të ankuesit gjeti se, ankuesja nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të dëshmuar pretendimet e saj ankimore. Prandaj Paneli apelin e ankueses e konsideron si të përgjithësuar dhe të pa argumentuar me fakte dhe si të tillë jo bindës pasi që nuk i plotëson kërkesat ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit 117 i Ligjit nr. 03/-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Rrjedhimisht PZAP-i në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në apel, konstaton se pretendimet në fjalë janë të pabazuara dhe të pa argumentuara dhe si të tilla apeli i ankuesit u refuzua.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
ZL.Anr.848/2017 me datën 12.11.2017.

Kryesuesi i Panelit
Zyhdë Haziri



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.